

Nisma të vogla për plakje aktive



AUSTRIAN RED CROSS



Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë

Nisma të vogla për plakje aktive



Nëpërmjet nismave dhe angazhimeve të shumta, njerëzit në moshën e tretë pasurojnë mjedisin e jetës së përditshme. Çdo moshë e jetës sjell mundësi të panumërta dhe kjo do të thotë se në moshën e tretë mund të kontribuohet dhe të realizohet në mënyrë aktive. Personat e moshuar kanë të drejtë të jenë qytetarë të barabartë dhe të jenë të mbrojtur nga diskriminimi. Të gjithë anëtarët e shoqërisë janë në gjendje për të dhënë në mënyrë të caktuar kontributin e tyre të dobishëm për komunitetin. Prandaj, detyrimi i shtetit dhe i secilit prej nesh është që të sigurohen kushtet për një pleqëri dinjitoze, jetë të shëndetshme dhe aktive.

Në këtë drejtim një kontribut aktiv dhe vëmendje jep dhe Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë përmes projekteve dhe iniciativave të shumta të suksesshme. Kjo fletushkë përmban gjashtë iniciativa të vogla të zbatuara përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe Kryqit të kuq të Velesit dhe Kriva Pallankës në kuadër të Projektit “Kujdesi për të moshuarit në kushte shtëpiake”, i mbështetur nga Kryqi i kuq i Austrisë. Këto iniciativa janë shembuj pozitivë të plakjes aktive të personave të moshës së tretë, të cilat duhet të zbatohen dhe të zhvillohen në vazhdimësi.

Rol i rëndësishëm në planifikimin e këtyre aktiviteteve është kontributi i përbashkët i të gjithë aktorëve aktivë në komunitet, që kontribuojnë në zbatimin e suksesshëm të nismave për plakje aktive dhe që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve në moshën e tretë.



“Iniciuesit e moshës së tretë”

Zbatues: Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit

Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është të inkurajuarit dhe të praktikuarit e plakjes aktive të personave në moshën e tretë në territorin e Shkupit. Nëpërmjet zbatimit të kësaj nisme u arritën disa rezultate:

- Është krijuar një rrjet i bashkëpunëtorëve për të inkurajuar njerëzit në moshën e tretë që të angazhohen në trajnimin për krijimin e fondeve të vogla në nivel lokal;
- Janë realizuar 3 trajnime, me të cilat janë trajnuar 60 persona për krijimin e fondeve të vogla në nivel lokal dhe 60 persona në moshën e tretë janë informuar për mënyrat e krijimit të fondeve të vogla në nivel lokal;
- Është promovuar plakja aktive përmes promovimit të trajnimeve për personat në moshën e tretë në mediet lokale dhe nacionale;

Këta individë të trajnuar hapin mundësinë që në të ardhmen të përfshihen në avancimin e kapaciteteve vullnetare në qendrat ditore për të moshuarit gjatë zbatimit të iniciativave në nivel lokal.





“Mësojmë për të lobuar për të drejtat tona”

Zbatues: Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit

Qëllimi kryesor i kësaj iniciative është që të inkurajojë plakjen aktive në mesin e njerëzve të moshës së tretë, duke krijuar parakushte për të lobuar për të drejtat e tyre. Nëpërmjet zbatimit të kësaj nisme janë realizuar disa rezultate:

- Është krijuar një rrjet i bashkëpunëtorëve për të inkurajuar njerëzit në moshën e tretë që të përfshihen në trajnime të komunikimit, shkathtësi komunikimi dhe lobim;
- Janë realizuar 2 trajnime, me të cilat direkt janë trajnuar 40 persona për krijimin e fondëve të vogla në nivel lokal dhe 40 persona në moshën e tretë janë informuar indirekt për mënyrat e krijimit të fondëve të vogla në nivel lokal;

Një nga mësimet e nxjerra nga kjo nismë është nevoja për qasje të vazhdueshme për të moshëtarit dhe vënia e tyre në rolin e lobistëve të vërtetë për të drejtat e tyre, si dhe organizimi i këso lloj aktivitetesh me karakter më të gjerë, ashtu që më shumë njerëz të moshës së tretë do të përfshiheshin.

“Lobimi - një mundësi për të ndihmuar”

Zbatues: Organizata komunale Kryqi i kuq - Veles

Qëllimi i kësaj iniciative është të krijojë një rrjet të 20 personave të rritur të trajnuar, të cilët përmes lobimit do të kontribuojnë në mes të njerëzve të moshës së tretë për t'u përfshirë në plakjen aktive, dhe kjo do të krijojë kushte më të mira dhe më cilësore të jetesës për të moshuarit në komunitet.

- Janë realizuar gjashtë trajnime, duke kontribuar kështu në afrimin e të moshuarve mes vete dhe fitimin e një jete më të mirë sociale, mbështetje të forcuar psiko-sociale, pavarësi, ndjenjë sigurie, rritje të vetëdijes për bashkëpunim kulturor mes brezave të ndryshëm, rritje të informimit në lidhje me të drejtat e të moshuarve, rritje të kapaciteteve të të moshuarve në komunikim aktiv me institucionet qeveritare dhe joqeveritare, rritje të njohurive të komunikimit elektronik, etj..

Mësimet e marra nga implementimi i iniciativës u mundësuan pjesëmarrësve për të fituar shkathtësi dhe vetëbesim për të realizuar të drejtat dhe nevojat e tyre, duke u bashkuar dhe lobuar për të drejtat e tyre.





“Aktivizohuni – asnjëherë nuk është vonë”

Zbatues: Organizata komunale e Kryqit të kuq - Veles

Qëllimi i iniciativës është përmirësimi i cilësisë së jetës së të moshuarve, duke i përfshirë ata në sfera të ndryshme të jetës.

- Janë mbajtur shtatë trajnime të fushave të ndryshme, me të cilat të moshuarit janë trajnuar për të përhapur njohuritë e marra nga fusha juridike, mjekësore, sociale dhe psikologjike. Theksi u vu në përmirësimin e qasjes së të moshuarve në institucionet dhe shërbimet për realizimin e së drejtës për mbrojtje sociale, si dhe qasjen e të moshuarve në institucionet dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor për të rritur integrimin e personave të moshuar në shoqëri.
- Janë organizuar dy punëtori kreative dhe dy manifestime humanitare, janë vizituar dhjetë persona të moshuar në Gradsko dhe dhjetë pensionistë në Shtëpinë e pensionistëve. Fondet e mbledhura nga aksionet humanitare ishin të destinuara për të ndihmuar një anëtar të Klubit të pensionistëve për të rinovuar ai shtëpinë e tij që kishte pësuar nga zjarri.
- Në debatin e fundit, ku morën pjesë rreth pesëdhjetë njerëz në moshën e tretë, gjysma e pjesëmarrësve shprehën interes për përfshirjen e tyre si vullnetarë të Kryqit të kuq -Veles, me qëllim që të japin kontribut aktiv në zbatimin e aktiviteteve të programit për dhe me njerëz të moshuar.

“Pleqëria - privilegj apo diskriminim”

Zbatues: Organizata komunale e Kryqit të kuq – Kriva Pallankë

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve individuale të njerëzve të moshuar, për të qenë ata vetë liderë në thyerjen e stereotipave se pleqëria është e barabartë me sëmundjen dhe dobësinë, për të fituar të moshuarit shkathtësi për të përmirësuar cilësinë e jetës për veten dhe bashkëmoshatarët e tyre, 30 të moshuar nga Kriva Pallanka, përmes punëtorive interaktive të organizuara nga ekspertët, mësuan si në vijim se:

- Rregullat e komunikimit janë shumë të rëndësishme në zgjidhjen e keqkuptimeve dhe mosmarrëveshjeve në familje dhe bashkësi;
- Të moshuarit kanë të drejta të veçanta që dalin nga Ligji për sigurim shëndetësor, Ligji për sigurim shoqëror, Ligji për sigurim pensionist, dhe institucionet janë të detyruara të respektojnë këto të drejta dhe të sigurojnë mbrojtje nëse dikush i shkel rregullat ligjore;
- Sipas dispozitave të Ligjit të trashëgimisë, personi i moshuar lirisht mund të disponojë me pasurinë e tij, por edhe duhet të ketë kujdes që të mos e dëmtojë sigurinë e tij materiale dhe financiare.
- Pleqëria është privilegj, për shkak se koha e lirë, shkathtësitë e shtypura dhe ëndrrat e parealizuara mund të realizohen përmes plakjes aktive – vullnetarizmit.





“Ne jemi këtu dhe ne mundemi”

Zbatues: Organizata komunale e Kryqit të kuq - Kriva Pallankë

Personat e moshuar më lehtë e kanë për të njohur nevojat e bashkëmoshatarëve të tyre. Me qëllim të përmirësimit të njohurive të tyre për të përcaktuar prioritetet e problemeve dhe nevojave të të moshuarve në zonat rurale, që të mund të iniciohen aktivitete dhe masa për ndërhyrje shoqërore në përmirësimin e cilësisë së jetës së këtij grupi të cenueshëm, 25 të moshuar të Kriva Pallankës kaluan trajnimin në metodën Zhvillimi i përbashkët i komunitetit, me theks të veçantë në mjetin bërja e Vlerësimit të shpejtë të përbashkët.

Grupi i trajnuar përgatiti një pyetësor, kreu vëzhgime në terren dhe hartografi, zgjodhi përfaqësues të komuniteteve lokale dhe zhvilloi intervista me 190 të moshuar në 6 zona rurale.

Pas përpunimit të të dhënave, u arrit konstatimi se të moshuarve në zonat rurale më së shumti u mungon kujdesi mjekësor dhe se mbizotëron ndjenja e vetmisë, e refuzimit dhe e izolimit.

Analiza e përgatitur u është dorëzuar institucioneve kompetente dhe do të kontribuojë në krijimin e politikave sociale në komunitetin lokal.





WWW.REDCROSS.ORG.MK

f www.facebook.com/CrvenKrstNaRepublikaMakedonija

You Tube www.youtube.com/MacedonianRedCross